



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË

Numri i lëndës: 2024:089955  
Datë: 23.12.2024  
Numri i dokumentit: 06638838

**P.nr.235/24**

**NË EMËR TË POPULLIT**

**GJYKATA THEMELORE NË PEJË - DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM**, me gjyqtaren e vetme gjykuese Blerta Kelmendi, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtores profesionale Leonita Lajçi Muçaj, në çështjen penale, kundër të pandehurit I.C, nga fshati ....., i komunës së Pejës, i akuzuar për veprën penale “*Lëndim i lehtë trupor*” nga neni 185 par.1 lidhur me nën par. 1.4 i KPRK-së, duke vepruar sipas Aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Pejë-Departamenti i Përgjithshëm, PP/II.nr.278/24, të datës 19.03.2024, pas shqyrtimit fillestar të mbajtur me datën 16.12.2024, në të cilën kanë qenë të pranishëm Prokurorja e Shtetit Lumturije Hoxha, i pandehuri I.C, me datë 18.12.2024, mori dhe publikisht shpalli, ndërsa me datë 23.12.2024, përpiloi këtë:

**A K T G J Y K I M**

**I pandehuri:**

**I.C**, i atësisë I. dhe amësisë A., e vajzërisë Sh., i lindur me ....., në ....., me vendbanim në fshatin ....., Komuna Pejë, me profesion ....., ka të kryer shkollën e mesme, i pa martuar, i gjendjes së mirë ekonomike, i identifikuar në bazë të letërnjoftimit me nr....., i lëshuar nga MPB Republika e Kosovës, posedon numër të telefonit ....., i nacionalitetit ....., Shtetas i Republikës së Kosovës, mbrohet në liri.

**ËSHTË FAJTOR**

**Për shkak se:**

*Me datën 24.11.2023, rreth orës 21:55, në fshatin Novosellë K.Pejë, pikërisht tek palestra e futbollit “.....”, me dashje i shkakton lëndim të lehtë trupor, i cili rezulton në dëmtimin e përkohshëm të shëndetit dhe atë të dëmtuarit E.D, në atë mënyrë që, pasi fillimisht i dëmtuari gjatë ndeshjes sportive debaton me njërin kundërshtar, aty ndërhyr i pandehuri dhe pasi e shtyen*

të dëmtuarin i drejtohet me fjalët “Çka ki ti me të” dhe në momentin që i dëmtuari i thotë “pse po përzihesh, ti nuk je duke luajt”, i pandehuri e godet me grusht në fytyrë, duke e alivanosur të dëmtuarin dhe ik nga vendi i ngjarjes, me ç rast nga kjo goditje, i dëmtuari pëson ndrydhje të indeve të buta të kokës dhe krahut të djathtë si dhe plagë shqyese në gjuhë, të shkaktuara nga veprimi mekanik i mjetit të fortë dhe si të tilla paraqesin lëndime të lehta trupore me pasoja të përkohshme në shëndet.

-Me çka ka kryer veprën penale “**Lëndim i lehtë trupor**” nga neni 185 par.1 lidhur me nën par.1.4 të KPRK-së.

Andaj, në bazë të nenit të lartcekur dhe neneve 1, 4, 7, 8, 9, 17, 21, 38, 39, 46, 47, 48, 49, 50, 69, 70, 71, 72 dhe 185 paragrafi 1 lidhur me nën par. 1.4 të KPRK-së, dhe neneve 240, 241 paragrafi 1, 242 paragrafi 2 nën paragrafi 2.1, 2.2, 2.3 dhe 24, 242 paragrafi 6, 364, 449 paragrafi 1 dhe 2 dhe nën paragrafi 2.6, 450, 452 paragrafi 1 dhe 462 paragrafi 2 të KPPRK-së, të pandehurin e:

## G J Y K O N

- I.** Me **DËNIM ME GJOBË**, në shumën prej një mijë (1000) euro, në të cilin dënim i llogaritet edhe koha e kaluar në ndalim policor prej dyzetetë (48) orësh, duke filluar nga dt. 26.11.2023 deri me 28.11.2023, ku një ditë e ndalimit i llogaritet në shumën prej njëzetë (20) euro, saktësisht shuma prej dyzetë (40) euro, me çrast i njëjti obligohet që të paguajë shumën prej shtatëqind e gjashtëdhjetë (960) euro, të cilin dënim i pandehuri obligohet të e paguaj brenda afatit prej gjashtëdhjetë (60) ditësh, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimit.
- II.** Nëse i pandehuri dënimin e shqiptuar në të holla dështon, refuzon apo nuk mund të paguan, gjykata dënimin me gjobë në bazë të nenit 43 par.3 të KPRK-së, do t’i zëvendësohet me dënim me burg, ku një (1) ditë burgim do të llogaritet me njëzetë (20) euro të gjobës.
- III.** Nëse i pandehuri nuk dëshiron ose nuk mund të paguajë gjobë në tërësi, gjykata do të e zëvendësojë pjesën e mbetur të gjobës në dënim me burgim. Nëse i pandehuri e paguan pjesën e mbetur të gjobës, ekzekutimi i dënimit ndërpritet.
- IV.** Obligohen të pandehurit që secili veç e veç të paguajë shpenzimet e procedurës penale dhe atë në emër të paushallit gjyqësor të paguajë shumën prej tridhjetë (30) euro si dhe në emër të taksës për kompensimin e viktimave të krimit të paguajë shumën prej njëzetë (20) euro, të gjitha këto në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarimit me dhunë.

V. I dëmtuari E.D, me vendbanim në rrugën “.....”, në Pejë, për realizimin e kërkesës pasurore juridike, udhëzohet në kontest të rregullt juridiko-civil.

### Arsyetim

Prokuroria Themelore në Pejë - Departamenti i Përgjithshëm, me datën 19.03.2024, ka ngritur aktakuzë nën shenjë PP/II.nr.278/24, ndaj të pandehurit I.C, për shkak të veprës penale “*Lëndim i lehtë trupor*” nga neni 185 paragrafi 1 lidhur me nën par. 1.4 të KPRK-së.

Gjykata në këtë çështje penale konform dispozitës së nenit 240 të KPPRK-së, caktoi dhe mbajti seancën e shqyrtimit fillestar me datë 16.12.2024, në praninë e Prokurores së Shtetit Lumturije Hoxha si dhe të pandehurit I.C, ndërkaq ka munguar i dëmtuari E.D, edhe përkundër faktit që të njëjtin gjykata e ka ftuar në mënyrë të rregullt.

Në seancën e shqyrtimit fillestar, të pandehurit gjykata i ka komunikuar të drejtat dhe detyrimet e tij ligjore konform nenit 241 paragrafi 1 të KPPRK-së, pas leximit të aktakuzës nga ana e Prokurores së Shtetit dhe pasi që gjykata është bindur së i pandehuri e ka kuptuar aktakuzën dhe veprën penale për të cilën akuzohet, të pandehurit i është dhënë mundësia që të deklarohej mbi fajësinë, por paraprakisht i janë shpjeguar kushtet, privilegjet dhe pasojat e pranimit të fajësisë, ashtu që i njëjti me vullnet të plotë dhe pa kurrfarë presioni ka deklaruar së pranon fajësinë për veprën penale e cila i vihet në barrë, respektivisht për veprën penale “*Lëndim i lehtë trupor*” nga neni 185 paragrafi 1 lidhur me nënpar. 1.4 të KPRK-së, ashtu siç ekziston në përmbajtje të aktakuzës, pa asnjë ndryshim dhe se i njëjti është i penduar, i vie keq për atë se çfarë ka ndodhur, me të dëmtuarin që nga ajo ditë nuk ka pasur probleme.

Gjykata gjatë seancës së shqyrtimit fillestar ka marrë mendimin e palëve në procedurë lidhur me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit, me ç’rast Prokurorja e Shtetit Lumturije Hoxha, ka deklaruar së: *pajtohem me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit, i njëjti pranim i plotëson kushtet ligjore, ka mbështetje në shkresat e lëndës, i propozoj gjykatë që këtë pranim fajësie ta aprovojë.*

Në vijim, gjykata ka shqyrtuar pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit në raport me dispozitat ligjore të nenit 242 paragrafi 2 nën paragrafi 2.1, 2.2, 2.3 dhe 2.4 të KPPRK-së, dhe gjeti së në rastin konkret të gjitha këto kushte janë përmbushur në mënyrë kumulative.

Kjo për faktin së gjykata ka gjetur së i akuzuari i ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë, një pranim i tillë paraqet shprehje të lirë të vullnetit të të akuzuarit dhe pranimi i fajësisë

nga ana e tij po ashtu gjenë mbështetje edhe në provat materiale siç janë: *Deklarata e të dëmtuarit E.D, e dhënë në Nën Stacionin Policor në .....e datës 24.11.2023; Deklarata e dëshmitarit M.C. e dhënë në Nën Stacionin Policor në ..... e datës 24.11.2023; Deklarata e të pandehurit I.C, e dhënë në Nën Stacionin Policor ..... e datës 26.11.2023; Akt ekspertimi mjeko ligjor punuar nga dr.Flamur Blakaj i datës 13.03.2024. Po ashtu, gjykata ka gjetur së aktakuza në fjalë nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike, ashtu që konform dispozitës së nenit 242 paragrafi 6 të KPPRK-së, ka miratuar pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit.*

Pasi që palët njëzëri kanë deklaruar se nuk propozojnë që të caktohet seanca e posaçme për matjen e dënimit e paraparë me nenin 356 par.1 të KPPRK-së, gjykata ka vazhduar seancën me shqiptimin e dënimit duke i ftuar palët që të deklarojnë lidhur me rrethanat rënduese dhe lehtësuese.

Sa i përket caktimit të llojit dhe lartësisë së dënimit Prokurorja e Shtetit Lumturije Hoxha i propozoi gjykatës: *si rrethanë lehtësuese të merret pranimi i fajësisë ndërkaq si rrethana rënduese ia lë në vlerësim gjykatës.*

I pandehuri I.C, ka deklaruar së: *jam penduar për veprën penale që kam kryer, i premtoj Gjykatës që në të ardhmen nuk do të kryej vepra penale, prej asaj dite të dëmtuarin nuk e kam parë, mirëpo me të njëjtin nuk kemi probleme e as nuk do të kem në të ardhmen, unë nuk kam probleme me askënd, kjo është hera e parë që gjendem që unë gjendem në gjykatë.*

Prandaj me faktet e ofruara në shkresat e lëndës, e po ashtu me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit është vërtetuar gjendja faktike si në dispozitiv të këtij aktgjykimi. Nga gjendja e vërtetuar faktike si është përshkruar në dispozitiv të këtij aktgjykimit, rrjedh se në veprimet e të pandehurit, qëndrojnë të gjitha elementet e veprës penale “*Lëndim i lehtë trupor*” par.1 lidhur me nëpar. 1.4 të KPRK-së.

Sa i përket fajësisë gjykata ka gjetur se te i pandehuri ka ekzistuar dashja që veprën penale ta kryen në mënyrë të përshkruar si në dispozitiv të aktgjykimit, pasi që i pandehuri ka qenë i vetëdijshëm për veprën e kryer dhe e ka dëshiruar kryerjen e saj.

Gjatë procedurës penale nuk janë paraqitur rrethana të cilat do ta zvogëlojnë apo përjashtojnë përgjegjësinë penale të pandehurit, kështu që i njëjti është penalisht përgjegjës.

Gjyqtarja e vetme gjykuese në bazë të nenit 69 dhe 70 të KPRK-së, i vlerësoi rrethanat lehtësuese dhe rënduese të cilat ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit, ashtu që si rrethana lehtësuese

gjeti se i pandehuri ka bërë pranimin e fajësisë për veprën penale që i vihet në barrë, ka shprehur keqardhje dhe është penduar për veprën penale të cilën e ka kryer, premtimin që nuk do të kryejë vepra penale në të ardhmen si dhe faktin se i njëjti nuk është i dënuar me parë, ndërkaq si rrethana rënduese gjykata përveç elementeve të figurës së veprës penale, në rastin konkret të tjera nuk gjeti.

Gjykata duke u gjendur para këtyre rrethanave të akuzuarin e gjykoi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi duke konsideruar se ky dënim është në përputhje me shkallën e përgjegjësisë penale të tij dhe me intensitetin e rrezikimit të vlerave të mbrojtura të shoqërisë dhe është bindur se vendimi mbi dënimin do të shërbej për arritjen e qëllimit të tij e që është pengimi i të akuzuarit në kryerjen e veprave penale në të ardhmen si dhe në preventivën tjetër për personat tjerë që të përmbahen nga kryerja e veprave penale konform nenit 38 të KRPK-së.

Andaj, mbi këto arsye, gjykata të pandehurit I.C, i shqiptoi dënim me gjobë duke marrë parasysh të lartcekurat e poashtu edhe gjendjen e tij ekonomike dënim i cili nuk do të ia vështirësoj mbijetesën, andaj i njëjti obligohet ta paguaj gjobën e lartcekur brenda periudhës së përcaktuar kohore si në pikën I të dispozitivit të këtij Aktgjykimi, e në përputhje me dispozitat ligjore të nenit 185 paragrafi 1 e lidhur me nën par. 1.4 të KRPK-së.

Vendimi si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi për llogaritjen e ndalimit të të pandehurve për dyzetetë (48) orë në dënimin e shqiptuar me gjobë, gjykata e mori duke u bazuar në nenin 79 par.4 të KRPK-së, i cili shprehimisht parasheh se: *“Një (1) ditë paraburgim, një (1) ditë heqje lirie, një (1) ditë burgim dhe njëzetë (20) euro të dënimit me gjobë barazohen për qëllime të llogaritjes sipas këtij neni”*.

Vendimi për kompensimin e shpenzimeve të procedurës penale dhe të paushallit gjyqësor, u mor në bazë të nenit 449 paragrafi 1 dhe 2, dhe nën paragrafi 2.6, nenit 450 dhe 452 paragrafi 1 të KPPRK-së, ndërsa vendimi lidhur me taksën për programin e kompensimit të viktimave, është marr konform nenit 36 paragrafi 1, 2, 3, nën paragrafi 3.1 të Ligjit për Kompensimin e Viktimave të Krimit, gjykata të pandehurin e obligoi në pagesën e taksës për kompensimin e viktimave të krimit.

Gjykata të dëmtuarin E.D, me vendbanim në rr. “.....”, në Pejë, për realizimin e kërkesës pasurore juridike e udhëzoi në kontest të rregullt juridiko civil në bazë të nenit 462 par 1 dhe 2 të KPPRK-së.

Nga sa u tha më lartë, e në kuptim të nenit 364 të KPPRK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË PEJË**  
**DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM-DIVIZIONI PENAL**  
**P.nr. 235/24, me datë 23.12.2024.**

**Bashkëpunëtorja profesionale**

**Gjyqtarja e vetme gjykuese**

**Leonita Lajçi Muçaj**

\_\_\_\_\_  
**Blerta KERMENDI**

**KËSHILLË JURIDIKE:**

Kundër këtij aktgjykimi ankesë mund të paraqesin personat e pakënaqur brenda tridhjetë (30) ditësh, nga dita e dorëzimit të kopjes së aktgjykimit. Ankesa parashtrohet përmes kësaj Gjykate, për Gjykatën e Apelit në Prishtinë.